



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/Delivered	14. 07 2022	2	viti god year
Organ /Aqesia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr Prot Dr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBACK	4133/2022		1/3



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.484/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të Procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.484/2022 të datës 26.05.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me referencë:DS-523/2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 28.04.2022, në çështjen juridike “pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me 14.07.2022 mori këtë:

V E N D I M

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.484/2020 e datës 26.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmes Vendimit të datës 28.04.2022 me numër reference:DS-523/2022 Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i ka shqiptuar masën “pezullim parandalues” me 50% të pagës me arsyetimin se ndaj të njëjtit organet kanë iniciuar procedurë penale pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Ankuesi, kundër vendimit të datës 28.04.2022 me numër reference:DS-523/2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 26.05.2022 me pretendimet ankimore se vendimi është i kundërligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 02.06.2022 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me datë 22.06.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës (faqe 1-12).

Kryetari i Këshillit me datë 08.07.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër VK.nr.66/2022 me qëllim të shtyrjes së afatit për vendosje edhe për dhjetë (10) ditë pune sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit të datës 07.07.2022 për shkak të nevojës të shqyrtimeve shtesë për shkak të specifikave të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritator administroj këto prova: Ankesën e ankueses të parashtruar me datë 26.05.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të parashtruar me datë 11.05.2022 në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimit me referencë:DS-037/2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimit me referencë:DS-523/2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Strukturën Organizative të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultatit në punë për ankuesin i datës 31.12.2020; Vendimin për pezullim parandalues i datës 05.03.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Administrator i Gjykatës; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën referent; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.06.2022; Përgjigjen e datës 22.06.2022 me shkresat e lëndës; Vendimin KA.nr.22/2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës 10.06.2022; E-mailin e datës 13.05.2022 dërguar nga \_\_\_\_\_ për E-mailin e datës 12.05.2022 dërguar nga \_\_\_\_\_ për E-mailin e datës 28.04.2022 dërguar \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ është e palejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa ndaj të njëjtit Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës përmes Vendimit të datës 28.04.2022 me numër reference:DS-523/2022 i ka shqiptuar masën "pezullim parandalues" me 50% të pagës, kurse ankuesi kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore "pezullim parandalues" me 50% të pagës ka parashtruar ankesë në Këshill me datë 26.05.2022.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të cilat janë të aplikuara për të punësuarit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, respektivisht neni 50 paragrafi 2 i tij ka përcaktuar se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike", ndërsa në bazë të shkresave të lëndës nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë pranuar Vendimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave apo Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të ketë vendosur për ankesën e ankuesit të datës 11.05.2022 përpara se i njëjti ta parashtrojë ankesën me datë 26.05.2022 në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës siç parashihet edhe në nenin 81 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës : "Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen

e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës” dhe po ashtu parashihet edhe me nenin 82 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj: “Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimit të ankesave. 2. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës”.

Andaj, në mbështetje të nenit 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: “Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”, nenit 16 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: “Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshill...” si dhe nenit 3 paragrafin 6 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: “Para parashtrimit të ankesës në Këshill, ankuesi duhet t’i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit...”, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 26.05 në Këshilli është e palejuar, pasi që i njëjti ankesën në Këshill është dashur ta parashtronte kundër vendimit të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave apo tek pasi të përfundon procedura vendimmarrëse brenda institucionit punëdhënës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me A.nr.484/2021

**Flakron GASHI**

Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesi;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

